

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË FERIZAJ sipas gjyqtares Hysnije Gashi, me pjesëmarrjen e sek. Juridike Imrane Shabani ,në procedurën kundërvajtëse kundër kemajl Ramadani nga Ferizaji , për shkak të kundërvajtjes nga neni 5.6 par.1.3 neni 9 dhe neni 17 par.1.3 par.1.3 të Ligjit për Deklarimin e Prejardhjes dhe Kontrollit të Pasurisë së zyrtarve të Lartë publik dhe deklarimin e prejardhjes dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar (Ligji nr. 04/L-050), dhe neneve 31,73 ,dhe 195 të Ligjit mbi Kundërvajtjet me datë 29.11.2012 merr këtë:

A K T V E N D I M

PEZULLOHET procedura kundërvajtëse kundër të pandehurit Kemajl Ramush Ramadani i lindur 22.02.1951 nga Ferizaji rruga Sami Frashëri nr. 5 .Delegate në Kuvendin Komunal në Ferizaj, e martuar 3 fëmijë, shkollen e mesme dhe apsulvente e shkolles së lartë . për kundërvajtjen e cila i ngarkohet në mungesë të provave e në vështrim të nenit 198 al.l pika 8 të Ligjit mbi kundërvajtjet.

Shpenzimet e procedurës bien në barrë të Gjykatës.

Nga një ekzemplar i këtij aktvendimi u dërgohet palëve.

A r s y e t i m i

Agjensionit kundër Korrpsionit në Prishtinë ,kësaj gjykate i parashtrou kërkesat nr. 01-2187 /2012 të dates 04.06.2012 për fillimin e procedurës kundërvajtëse kundër të pandehurit Kemajl Ramadani , për shkak të kundërvajtjes bga neni 5.6 par.1.3 , neni 9 dhe 17 par.1.3 të ligjit nr.04/L-040/.

Gjyatarja filloi procedure kundërvajtëse , mori në pyetje të pandehurit i cili në mbrojtjen e tij deklaroi se si delegatë i Kuvendit Komunal në Ferizaj, unë personalisht nuk kamë pranuar formularin për deklarimin e pasurisë dhe as që kamë qenë e njohtuar se prej dates 01.deri me 31.03.2012 duhet ta plotësoi të njejtin, nuk kamë pasur asnjë arsye që mos ta plotësoi formularin përveq se nuk kamë qenë e njohtuar nga zyrtari Naser Musa dhe për këtë jamë njohtuar nga medijat pastaj me daten 11.09.2012 kamë bërë deklarimin e pasurisë të cilen ia prezentoj Gjykatës si provë .

Për vertetimin sa më të plotë të gjendjes faktike gjyqtarja ftoi personin kontaktues me zyrën e Agjensionit kundër korrupsionit Naser Musa I cili në deklaratën e tij thekësoi se nga Agjensionit kundër korrupsionit ka pranuar njoftimin për zyrtarët e lartë të cilët kanë qenë të obliguar që ta bëjnë deklarimin e pasurisë pastaj unë në konsultim me kryesuesin e Asmbles komunale Agim Aliun dhe zyrtarin për marvatje të Kuvendit Afrim Matoshin jemi konsultuar dhe forumularët për deklarimin e Pasurisë I kemi vendosur në tavolinat e delekatëve komunal ku para fillimit të séances së kuvendit kryesuesi I ka njohtuar të gjith delegatët se materialin e kanë të vendosur në tavolinë dhe të njejtin duhet ta plotësojnë dhe ta përcjellin në Agjension kundër korrupsionit si dhe prezeton listen e deklegatve të cilët kanë marrë pjesë në mbledhjen e dates 09.03.2012 .

Gjyqtarja mori deklaratën e dëshmitarit Afrim Matoshi zyrtar për marvajtjen e Kuvendit komunal në Ferizaj, I cili deklaroi se formularët i kamë vendosur në ulset e deputetve dhe se kryesusi I kuvendit I ka njohtuar deklegatët se duhet të plotësohen dhe të dorzohen në Agjensionin kundër korrupsionit.

Dëshmitari Agron Behrami zyrtar në Agjensionin kundër korrupsionit , I cili deklaroi se sa I përket kërkeses së parashtruar në bazë të Ligjit , në listen e zyrtarve të lartë të cilët duhet të deklarojnë pasurinë ka hyrë edhe një numer I zyrtarve të cilët më herët nuk e kanë deklaruar ,ne kemi njohtuar personin zyrtar kontaktues Naser Musa ,dhe kemi kërkuar nga ai që ti informoj të gjith kshilltarët komunal dhe zyrtarët të tjerë rreth deklarimit të pasurisë së tyre .Në pyetjen e gjyqtares dëshmitari përgjigjet se kërkesë të veqant për deklarimin e posurisë nuk I kemi dorzuar personave zyrtar nga se këtë nuk e parasheh ligji., mirëpo njoftimin e kemi bërë permes zyrtarit kontaktues Naser Muses .

